



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 182, Datë 29.05.2023

MBI

FILLIMIN E PROCEDURËS PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “SOLE 24 DOOEL SHKUP–DEGA NË SHQIPËRI” DEGË E SHOQËRISË SË HUAJ, NË VEPRIMTARINË E FURNIZIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të neneve 16 dhe 37, pika 2, gërma “ç”, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; nenit 4, pika 1, gërma “d”, nenit 5, pika 1, gërma “d” dhe nenit 10, pikat 1 dhe 3 të Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike, të miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.06.2016, e ndryshuar; si dhe neneve 15 dhe 19, pika 1, gërma “a” të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 29.05.2023, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1433/1 prot., datë 26.05.2023, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, “Mbi kërkesën e shoqërisë “SOLE 24 DOOEL Shkup–Dega në Shqipëri”, Degë e shoqërisë së huaj, për licencim në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike”,

Konstatoi se:

- Shoqëria “SOLE 24 DOOEL SHKUP–Dega në Shqipëri”, degë e shoqërisë së huaj, me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1433 prot., datë 19.05.2023, ka paraqitur kërkesën për licencim në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike.
- Në zbatim të përcaktimeve të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.06.2016, e ndryshuar, aplikuesi për licencim në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike duhet të depozitojë në ERE: dokumentacionin e përgjithshëm për të gjitha aplikimet për pajisjen me licencë (neni 9, pika 1); dokumentacionin specifik për licencën e furnizimit të energjisë elektrike

(neni 9, pika 2.4); Shtojcën 1 dhe Shtojcën 1/D të plotësuar; si dhe të ketë kryer pagesën për regjistrim dhe shqyrtim të aplikimit (Aneksi A).

- Shoqëria ka kryer për llogari të ERE-s pagesën e aplikimit në zbatim të Aneksit A të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike” e ndryshuar.
- Nga shqyrtimi i këtij aplikimi rezulton se shoqëria “SOLE 24 DOOEL Shkup–Dega në Shqipëri”, degë e shoqërisë së huaj, ka plotësuar dokumentacionin në zbatim të nenit 9 për pikën 1.1, gërmat “a”, “b” dhe “c”; për pikën 1.2, gërmat “c” dhe “d”; për pikën 1.3, gërmat “a”, “b” dhe “c” si dhe për pikën 2.4, germën “a”.
- Nga ky aplikim rezultojnë mungesa në dokumentacionin si më poshtë:
 - *Pika 1.2 Dokumentacioni juridik dhe administrativ*
 - **gërma “a”**: Vlerësohet t’i kërkohet shoqërisë që të përfshijë veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike në objektin e ekstraktit në regjistrin tregtar të depozituar në Qendrën Kombëtare të Biznesit.
 - **gërma “b”**: Referuar kërkesave specifike të kësaj pike të rregullores, shoqëria duhet të depozitojë dëshmitë e penalitetit, për vetë shoqërinë dhe administratoren.
 - *Pika 2.4 Dokumentacioni juridik dhe administrativ*
 - **gërma “b”**: Shoqëria ka referuar se ka depozituar bashkëlidhur kontratën mbi sistemin IT që do të operojë por me qëllim për të kuptuar më shumë rreth këtij shërbimi, vlerësohet që t’i kërkohet që në vijim të depozitojë në ERE këtë kontratë.
 - **gërma “c”**: Referuar dokumentacionit të depozituar, rezulton se shoqëria ka një kontratë të vlefshme për disponimin e zyrave për të ushtruar aktivitetin e furnizimit. Afati i vlefshmërisë së kontratës është 1-vjeçare dhe nuk mbulon të 5 vitet e licencës, ndaj vlerësohet që t’i kërkohet shoqërisë informacion mbi disponimin e zyrave përkatëse pas përfundimit të kësaj kontrate.
- Për dokumentacionin e munguar, do të njoftohet aplikuesi që ta depozitojë atë brenda afatit të përcaktuar nga ERE.
- Në kuadër të plotësimit nga aplikuesi të dokumentacionit thelbësor sipas kërkesave të rregullores, vlerësohet fillimi i procedurës për këtë aplikim.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “SOLE 24 DOOEL Shkup–Dega në Shqipëri”, Degë e shoqërisë së huaj, në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike.
2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes dijeni, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Petrit AHMETI